



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Janar 2025

Data 29.01.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 23.12.2024 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.
- 2.Projekt vendim për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025.
- 3.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2024.
- 4.Projekt vendim për rishikim të Vkb nr.87 datë 23.12.2024 për shtyrjen e afatit të Vkb Vau Dejës nr.71 datë 26.11.2020”Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021” i ndryshuar me VKB nr.64 datë 26.11.2021, lënë në fuqi me VKB nr.78 datë 30.11.2022 dhe ndryshuar me Vkb nr.84 datë 30.11.2023, në shprehjen e ligjshmërisë nga Institucioni Prefektit Qarkut me nr.863/1 prot. datë 06.01.2025, me ndryshimet përkatëse sipas sugjerimeve të ardhura me shkresën nr.45/2 prot. datë 09.08.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Takses së Pasurisë(Drejtoria Metodologjisë dhe Ligjore) Tiranë.
- 5.Projekt vendim për miratimin e shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës”.
- 6.Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb nr.95/2024 mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Gezim Osman Mahmutaj i dëmtuar nga zjarri me datë 26.10.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”.
- 7.Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb nr.96/2024 mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Arben Ceko Et’hem i dëmtuar nga zjarri me datë 05.11.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”
- 8.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Mandalina Mark Dragusha e dëmtuar nga zjarri me datë 13.12.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës.
- 9.Projekt vendim për miratimin e listës së ngastrave /nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim për vitin 2025.
- 10.Projekt vendim për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje Bari dhe e pyjeve që kullohen për vitin 2025.
- 11.Të ndryshme.



Grupe interesi nuk kishte prezent në mbledhje. Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Janarë 2025, u zhvillua me datë 29.01.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija. Të pranishëm në sallë ishin 18 këshilltarë, (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj, Arsen Mehmeti) korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 18 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 23.12.2024 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 23.12.2024 nga Z.Ervis Shimaj. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarëve ju spjeguan arsyet e kthimit nga Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër. për vendimet nr.87,94,95,96

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyles se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se kriteret specifike te vitit 2025 mbi te cilat do te bazohet VKB per te trajtuar me ndihme ekonomike duke perdorur deri ne 6% te fondit te kushtezuar per bllok ndihmen ekonomike familjet te cilat nuk shpallen fitues sipas formulese se pikezimit.

1. Familje te varfëra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme, qe nuk plotësojne nevojat buzë per jetesë.
2. Familje qe kanë ne përberje nje ose me shumë anetare me aftësi te kufizuar/invalid pune.
3. Familje me shume femije
4. Familje me k/familjare femra pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme, dhe me probleme sociale.
5. Persona qe jetojnë te vetëm, te moshuar, qe kanë dhe probleme shendetesore
6. Familje me te ardhura te pamjaftueshme qe ka në përberje femijë qe ndjekin arsimin e lartë,
7. Familjet qe nuk kanë banese ose jetojnë me qera.
8. Familje qe kanë ne përbërje të moshuar, qe nuk kane pension ose e kane pension minimal.



9. Kryefamiljare gra te veja apo te divorcuara pa të ardhura apo me të ardhura te pamjaftueshme

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani,Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj,Arsen Mehmeti)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se , bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Dhjetor 2024, te perfitojne 136 familje, me 472.767 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Dhjetor 2024 janë shpallur fitues, 1.015 familje, me fond 7.883.061 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 472.983 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani,Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj,Arsen Mehmeti)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për rishikim të Vkb nr.87 datë 23.12.2024 për shtyrjen e afatit të Vkb Vau Dejës nr.71 datë 26.11.2020”Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021” i ndryshuar me VKB nr.64 datë 26.11.2021, lënë në fuqi me VKB nr.78 datë 30.11.2022 dhe ndryshuar me Vkb nr.84 datë 30.11.2023, në shprehjen e ligjshmërisë nga Institucioni Prefektit Qarkut me nr.863/1 prot. datë 06.01.2025, me ndryshimet përkatëse sipas sugjerimeve të ardhura me shkresën nr.45/2 prot. datë 09.08.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë(Drejtoria Metodologjisë dhe Ligjore) Tiranë.



Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se për këtë pikë të rendit të ditës është mbledhur komisioni i financave, buxhetit, pasurive Bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, mbikqyrjes financiare dhe ka konstatuar se në projekt vendimin e paraqitur për shqyrtim, janë zbatuar me korrektesi sugjerimet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (Drejtoria Metodologjisë dhe Ligjore) Tiranë me nr.45/2 datë 09.08.2024, kjo e kërkuar për zbatim edhe nga Institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër, shprehje ligjshmërie me nr.863/1 datë 06.01.2025 dhe ka propozuar miratimin e projekt vendimit në mbledhjen e muajit Janarë 2025.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro, zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ervis Shimaj, Rita Preçi, Ornella Lleshi, Mirela Vasija, Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani, Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj, Arsen Mehmeti)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me Vkb nr.84 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës".

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Z.Edmond Gjeçaj-përfaqesues i zyrës mbrojtjes, përfshirjes dhe strehimit social, i cili relatton për këshilltarët se në kuader të Planit Social Vendor 2021-2023, miratuar me VKB-në Nr. 84, datë 24.12.2020, Bashkia ka aplikuar me kërkesë për financim të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor me projektin "Shërbim Lëvizës në Familje për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar në Bashkinë Vau Dejës", në thirrjen e hapur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në programin e Fondit Social 2024 dhe kërkesa është aprovuar. Projekti "Shërbim Lëvizës në Familje" ka pasur një nisje të suksesshme gjatë vitit të parë të zbatimit, duke ofruar shërbime në familje për familjet me aftësi të kufizuar që kanë nevojë për mbështetje dhe trajtim në kushte të përshtatshme dhe të sigurta për ta. Ky projekt ofrohet nga një ekip i përbërë nga katër profesionistë të kualifikuar: logopedi, punonjësi social, fizioterapisti dhe psikologu. Secili prej këtyre profesionistëve ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe familjeve që kanë marrë shërbimin. Në vitin e parë të zbatimit, kemi arritur të implementojmë një sërë aktivitete dhe ndërhyrjesh që kanë pasur një ndikim pozitiv në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve, duke ofruar mbështetje në fushat e zhvillimit të aftësive të komunikimit, shëndetit mendor, rehabilitimit fizik dhe ndihmës sociale. Ky sukses i projektit është reflektuar në vlerësimet pozitive të pranuar nga familjet dhe partnerët e projektit, të cilët kanë theksuar rëndësinë e shërbimeve të ofruara dhe ndikimin e drejtpërdrejtë në jetën e tyre. Tani, në vitin e dytë të implementimit të projektit, synojmë të vazhdojmë këtë projekt me thellimin e shërbimeve që ofrohen, duke ofruar mbështetje edhe më të specializuar për nevojat e ndryshme që mund të shfaqen gjatë kohës për fëmijët. Ekipi i Njësisë Lëvizëse do të vazhdojë të punojë ngushtë



me çdo familje për të siguruar që çdo fëmijë pjesë e këtij projekti të marrë shërbimin që i nevojitet për zhvillimin dhe mirëqenien e tij.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani,Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj,Arsen Mehmeti)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb nr.95/2024 mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Gezim Osman Mahmutaj i dëmtuar nga zjarri me datë 26.10.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Valjeta Nikaj – përgjegjëse e zyrës emergjencave civile, Bashkia Vau Dejës e cila relaton për projekt vendimin dhe spjeron se në muajin Dhjetor është marrë vendim nga këshilli për dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Gezim Osman Mahmutaj i dëmtuar nga zjarri me datë 26.10.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”,por institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër ka kërkuar vleresim të dëmit pasi ndertesa nuk është dëmtuar plotësisht, dhe pasi janë plotësuar këto kërkesa nga ana jonë e paraqesim projekt vendimin për rishikim.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e gjashtë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani,Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj,Arsen Mehmeti)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për rishqyrtim i Vkb nr.96/2024 mbi “Dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Arben Ceko Et’hemi i dëmtuar nga zjarri me datë 05.11.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës”

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Valjeta Nikaj – përgjegjëse e zyrës emergjencave civile, Bashkia Vau Dejës e cila relaton për projekt vendimin dhe spjeron se në muajin Dhjetor është



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

marrë vendim nga këshilli për dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasit Arben Ceko Et'hemi i dëmtuar nga zjarri me datë 05.11.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës” por institucioni i Prefektit Qarkut Shkodër ka kërkuar procesverbal të dëmëve ndertimore.Gjatë inspektimit nga ana jonë ka rezultuar që nuk ka dëme ndertimore kjo banesë, për këtë arsye projekt vendimin e kemi shoqeruar me relacionin përkatës dhe me foto të qarta që pasqyrojnë dëmin.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e shtatë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani,Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj,Arsen Mehmeti)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasës Mandalina Mark Dragusha e dëmtuar nga zjarri me datë 13.12.2024, banorë i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Valjeta Nikaj – përgjegjëse e zyrës emergjencave civile, Bashkia Vau Dejës e cila relatton për projekt vendimin dhe spjeron se është bërë procesverbali i konstatimit të dëmëve,vlerësimi i dëmëve, këto në bazë të urdherit të Kryetarit Bashkisë për ngritjen e komisionit.Propozojmë dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme familjes së shtetasës Mandalina Mark Dragusha e dëmtuar nga zjarri me datë 13.12.2024,në masen 50% të vleres totale të dëmit shumen prej 709.425 lek.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e tetë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani,Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj,Arsen Mehmeti)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e listës së ngastrave /nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim për vitin 2025.



Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli – inxhinjer, specialist pranë Drejtorise pyjeve, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se projekt vendimi për miratimin e listës së ngastrave /nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim për vitin 2025, paraqitet per miratim çdo vit me detyrimin ligjorë që këto lista të jenë të miratuara nga këshilli bashkiak në mënyrë që gjatë viti 2025 këshilli bashkiak të ketë mundësinë e dhënies së tyre në përdorim apo me qira.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e nëntë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani,Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj,Arsen Mehmeti)

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje Bari dhe e pyjeve që kullohen për vitin 2025.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Z.Mark Suli – inxhinjer, specialist pranë Drejtorise pyjeve, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se projekt vendimi për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje Bari dhe e pyjeve që kullohen për vitin 2025, paraqitet per miratim çdo vit me detyrimin ligjorë që këto lista të jenë të miratuara nga këshilli bashkiak në mënyrë që gjatë viti 2025 këshilli bashkiak të ketë mundësinë e dhënies së tyre në përdorim apo me qira.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 18 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.**

Këshilltarët që votuan Pro piken e dhjetë të rendit të ditës: (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija,Sanije Salja, Meliha Zyberaj, Vjollcë Zagani,Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj,Arsen Mehmeti)

Pika 11: Të ndryshme.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët për të diskutuar për ndonjë problem apo shqetësim nëse kanë.

Këshilltarët u shprehën se nuk kishin problematik për të diskutuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pasi këshilltarët nuk kishin diskutime tjera, Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës e deklaroi të mbyllur mbledhjen e rradhës së muajit Janarë 2025.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

- Ervis Shimoj
- Mark Bish
- Lamçe Selja
- Martin Korolodan
- Arben Mehmetij
- Mirela Vasija
- Alina Livadhi
- Besmir Koroj
- Frauo Bregu
- Yllë Zogari
- Rita Breci
- Leonore Prenga
- Melike Zyberaj
- Martina Koneva
- Klirida Tashaj
- Qinela Lleshi
- Frasë
- Mela Topallari